

S T A T U T
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
« ARTAN DERVISHI » Sh.p.k.



Ne Tirane, sot me daten 08. 02. 2018 (dymije e tetëmbedhjete), personat fizik:

1. **Artan DERVISHI**, atesia Haki, i lindur më 03.02.1977, ne Shijak, Durres, me dhe banues ne Shijak, Koxhas, Durres, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 029047581 dhe numer personal H70203012M, përdorues i cel: +355 0673217543; e mail: artandervishi325@gmail.com.
2. **Enio HAXHIU**, atesia Bashkim, lindur ne Rreshen, me date 13.12.1991, dhe banues ne adresen: Shijak, Maminas, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit 027246275 dhe numer personal J11213074D, përdorues i e mail: haxhiuenio@gmail.com

mbështetur në legjislacionin Shqiptar në fuqi, kryesisht në ligjin Nr. 9901 dt 14.04.2008. "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", i ndryshuar dhe te akteve te tjera ligjore ne fuqi ka përpiluar dhe nënshkruan sot Statutin e Shoqerise si me poshte vijon:

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "ARTAN DERVISHI" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") eshte një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni në fuqi.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Ky Statut eshte perpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm për nënshkruesit e tij. Çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1. Emërtimi i Shoqërisë është: "ARTAN DERVISHI" Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

Shoqeria « ARTAN DERVISHI» Sh.p.k. krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete:

- Rritje shpendesh. Ngritjen e ambienteve per ruajten dhe perpunimin e produkteve blegtorale dhe bujqesore (theriore dhe ambiente frigorferike per therjen dhe ruajtjen e mishit te pules).
- Ndertimin e serave per produkte bujqesore. Mbjelljen e kultivimin e te gjitha llojeve te produkteve bujqesore.
- Tregetimin e kulturave bujqesore e blegtorale me shumice dhe pakice.
- Sherbime ne fushen e bareve, restoranteve, picereve, prodhimeve te brumit e prodhimeve te tjera me karakter ushqimor si dhe kryerjen e sherbimeve dere me dere lidhur me prodhimet e mesiperme. Importimin, eksportimin e tregtimin e te gjitha llojeve, materialeve, makinerive, pajisjeve e impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, turistik, buqesor, tregtar, ushqimor, kulturor, sportiv, te sherbimeve, etj, ne



teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Studimin dhe krijimin e linjave te prodhimit, te cdo lloj artikulli te gatshem apo gjysme te gatshem.

- Katering industrial qe ka te beje me pergatitjen dhe furnizimin me ushqime periodike per punonjesit dhe stafet drejtuese te institucioneve dhe organizatave te ndryshme shteterore apo private, ndermarrjeve prodhuese apo tregtare, punetoreve ne vepra ndertimi te ndryshme te ndodhura ne objekte te levizshme dhe jo te levizshme, pacienteve dhe mjekeve te spitaleve apo klinikave, te denuarve neper burgje apo dhoma paraburgimi, ushtarakeve neper reparte ushtrie, nxenesve dhe studenteve neper shkolla dhe universitetet shteterore dhe private, pasagjereve te kompanive ajrore, selive diplomatike, etj.
- Katering eventesh te ndryshme qe ka te beje me pergatitjen e produkteve ushqimore ne forme banketi ose ne forme tradicionale te sherbimit per: festa, dasma, ditelindje, funerale, ceremoni dhe aktivitete te llojeve nga me te ndryshmet, coffe break, etj. Katering per subjekte rishites, qe ka te beje me furnizimin me produkte ushqimore te gatshme dhe gjysem te gatshme, te supermarketet, hoteleve, restoranteve, pikave te karburanteve dhe cdo subjekti tjeter tregtar te interesuar.
- Te kontraktojë me persona fizike dhe juridike vendas ose te huaj per gjetjen e tregjeve te shitjes per prodhimet dhe sherbimet e shoqerise.
- Te krijoje lidhje, te regjistrohet, te pjesmarrë ne çfardo institucion, organizim, rrjet që konsiderohen nga shoqeria te leverdishme, e qe ben te ecin perpara interesat dhe zhvillimi i shoqerise.
- Te kryeje veprimtari perfaqesimi, prokurimi, pronesie, konfirmimi, administrimi te pasurive si dhe te kryeje veprimtari nepunesie ose sekretarie, ndermjetesimi ose promovimi te personave juridike te cdo kategorie ose parametri qe veprojne dhe kanë qellime te ngashme me shoqerinë.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e shoqerise do te jete ne adresen: Durres, Shijak, Fshati Koxhaze, ndertese private, 1-kateshe, zona kadastrale nr. 2255, me numer pasurie 11/13.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjeter bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve ia delegon organit administrativ kompetencën per hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë..

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë eshte e pakufizuar ne kohe.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përparrë këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, formuar nga ortaket themelues, ne 2 (dy) kuota, te zotëruar nga:
 1. Artan DERVISHI, zoteron një kuotë, respektivisht 50 % te kapitalit te shoqerise.
 2. Enio HAXHIU, zoteron një kuotë, respektivisht 50 % te kapitalit te shoqerise.

- 6.2 Kapitali themeltar mund tē rritet pa kufi nē çdo moment, një ose disa herë, nē përputhje me legislacionin nē fuqi.
- 6.3. Rritja e kapitalit behet me vendimin të Asamblesë së Ortakëve. Vendim i vlefshëm merret vetëm nëse ortakët janë tē pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 te ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".
- 6.4. Zmadhimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve nē proporcion me pjesët e kapitalit tē zotëruara prej tyre.

Neni 7 – Angazhime të Ortakëve

- 7.1. Ortaku themelues Artan DERVISHI do tē vendos si kontribut tē tijin, nē dispozicion tē shoqërisë "Artan DERVISHI" shpk dhe si aset tē saj tē gjithë përvjetorë profesionale, know how, shprehitë edhe njohuritë e përfituar nga ai vete si individ dhe si Person Fizik 'Artan DERVISHI', titullar i numrit unik i identifikimit tē subjektit NUIS: L01717004N.
- 7.2. Ortaku themelues Artan DERVISHI sipërmerr që për aq sa ligji e mundëson tē vendosë nē shërbim tē shoqërisë "Artan DERVISHI" shpk licensën "Tregtia me shumicë e kafshëve tē gjalla", LN-2215-10-2016, e zotëruar prej tij nē cilësinë e Personit Fizik 'Artan DERVISHI'.
- 7.3. Ortaku themelues Artan DERVISHI do tē realizojë tē gjitha hapat proceduriale përfitimin e licensës "Tregtia me shumicë e kafshëve tē gjalla".

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1. Shoqëria mund tē zvogëlojë kapitalin themeltar.
- 8.2. Zvogëlimi i kapitalit behet me vendimin të Asamblesë së Ortakëve, kur votohet pro me unanimitet tē tërësisë së votave tē Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund tē zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 8.3. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve nē tē njëjtën masë me pjesët e kapitalit tē zotëruara prej tyre.

Neni 9 – Transferimi i kuotave

- 9.1. Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes nē favor tē ortakëve tē tjerrë.
- 9.2. Në një rast tē tillë, ortaku që do tē transferojë kuotat e tij tē kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerrë.
- 9.3. Njoftimi bëhet me letër rekomande me kthim përgjigje dhe/ose me Leter Njoftimi nepermjet adreses elektronike (në vijim "Njoftimi"),
- 9.4. Në njoftim përcaktohen:
- (a) numrin i kuotave tē ofruara për shitje;
 - (b) emrin e blerësit/përfituesit tē ofruar;
 - (c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar nē çdo rast nē para, ose nē vlerën nē para nē rast tē një kundërshtpërbllimi tjeter tē mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksi, dhe çdo rast tjeter transferimi me shpërbllim), ose vlerën e objektit tē transferimit nē rastin e transferimit pa shpërbllim;
 - (d) modalitetet e pagesës;
 - (e) ftesën për tē ushtruar tē drejtëni e parablerjes.

Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjerë të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes.

E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

- 9.5. Ortakët do të kenë në dispozicion 3 (tre) muaj nga marja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 9.6. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përvèç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 9.7. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'i transferohen blerësit të ofruar sipas çmimit të specifikuar.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 10 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 10.1. Asambleja e Ortakëve është organi vendim-marrës i Shoqërisë.
- 10.2. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse dhe merr vendim me unanimitet për çështjet vijuese:
 - ndryshimet e satutit,
 - zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit,
 - riorganizimi dhe prishja e shoqërisë,*si edhe*
 - për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut, nga një Vendim Unanim i Ortakëve të shoqërisë dhe nga legjislacioni përkates.
- 10.3. Asambleja e ortakeve vendos ne perputhje me legjislacionin ne fuqi persa i perket: emërimit e shkarkimit të administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, per politikat tregetare te shoqerise; per mbikqyrjen e politikave tregetare te aplikuara nga administratoret, perfaqesimi ne gjykate dhe ne procedime te tjera per administratoret e tjere si dhe ne lidhje me cdo vendim tjetër te parashikuar ne Statut ose nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 11 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 11.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 11.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 11.3. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim vetëm për një pjesë të kapitalit që zotëron.

Neni 12 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 12.1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe te inventarit.

- NOTE*
- 12.2. Asambleja mund tē thirret nē çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kérkeses qē do ti drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve qē përfaqësojnë tē paktën 5% (pesë) përqind tē kapitalit themeltar. Asambleja thirret nēpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Poste elektronike.
 - 12.3. Lajmerimi do t'u dërgohet ortakëve jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
Në rast njoftimi me poste elektronike, përveç afatit 7 ditor jepet edhe një periudhe shtesë prej 5 (pesë) ditësh kalendarike. Njoftimi per seicilin ortak dergohet ne adresat respektive pershkruar ne hyrje te ketij akti.
Thirrja duhet tē përbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi rendin e ditës qē do tē trajtohen dhe për tē cilat do tē merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.
 - 12.4. Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve konform ligjit do tē thirret me tē njëtin rend dite.
 - 12.5. Mbledhjet e Asamblesë mund tē mbahen edhe nēpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht qē tē gjithë pjesëmarrësit tē mund tē identifikohen dhe t'u lejohet atyre tē ndjekin diskutimin dhe tē ndërhyjnë nē momentin e trajtimit tē çeshtjeve nē rend tē ditës; pasi tē janë verifikuar këto kérkesa qē duhet tē rezultojnë nē procesverbalin e mbledhjes.
 - 12.6. Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nese Asambleja mblidhet ne seline e shoqerise. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formalitetave tē njoftimit e te vendmbajtjes nē rast se janë tē pranishëm ortakët qē përfaqësojnë tē tërë kapitalin themeltar.
 - 12.7. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve qē kërkojnë një shumicë tē zakonshme janë tē vlefshme nëse nē tē janë tē pranishëm ortakët me tē drejtë vote qē zotërojnë më shumë se 30 (tridhjet) për qind tē kuotave
 - 12.8. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për tē cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, perjashto vendimet e parashikuara nē nenin 10.2 janë tē vlefshme nëse janë tē pranishëm ortakët me tē drejtë vote qē zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) tē kapitalit themeltar.
 - 12.9. Per drejtimin e puneve ne çdo Asamble zgjidhet një Kryetar, ortak ose ndonjë përsone tjeter jo-ortak i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, qē mund tē jetë edhe jo-ortak.
 - 12.10. Vendimet e Asamblesë duhet tē nënshkruhen nga Ortaket.

Neni 13 – Njoftimi

- 13.1. Njoftimi i ndersjellte ndermjet Administratorit, Personelit drejtues dhe bashkepunetoreve te shoqerise, do te realizohet nēpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Poste elektronike; d) njoftimit ne faqen zyrtare elektronike te shoqerise;
- 13.2. Njoftimi me poste elektronike do tē konsiderohet i kryer me kalimin e një afati total prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e nisjes se e-mailit nga njoftuesi. Ky aftat përbehet dhe është shumatore e afatit minimal ligjor prej 7 (shtatë) ditë dhe afatit prej 5 (pesë) ditësh kalendarike tē lënë nē dispozicion per konsultim tē emailit.
- 13.3. Njoftimi per seicilin ortak dergohet ne adresat respektive pershkruar ne hyrje te ketij akti.

- Administratori, Personeli drejtues dhe bashkepunetoret e kontraktuar nga shoqeria duhet te depozitojne adresen e tyre elektronike ne shoqeri;
- 13.3. Njoftimi nepermjet faqes zyrtare elektronike te shoqerise konsiderohet i kryer me kalimin e afatit te parashikuar ne ligji.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.
- 14.2. Shoqeria drejtohet nga një Administrator, i cili zgjidhet për një periudhë prej tre (3) vjet, me të drejtën për tu riemëruar nëse Asambleja nuk vendos ndryshe para mandatit të administratorit.
- 14.3. Adminsitratori i shoqerise « ARTAN DERVISHI» Sh.p.k. emerohet:
Artan DERVISHI, atesia Haki, i lindur më 03.02.1977, ne Shijak, Durres, me dhe banues ne Shijak, Koxhas, Durres, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 029047581 dhe numer personal H70203012M, përdorues i cel: +355 0673217543; e mail: artandervishi325@gmail.com.
Adminsitratori i shoqerise ushtron kompetencat e parashikuara ne ligji.
Adminsitratori i shoqerise, Zotni Artan DERVISHI, emerohet per nej afat 3 (tre) vjet nga data e nenshkrimit te këtij akti.
- 14.4. Administratori ushtron kompetencat e tij në përputhje me nenin 95 te ligjit nr. 9901/14.04.2008 "Per tregtarët dhe Shoqërите Trëgëtarë" duke respektuar në çdo rast kufijtë e kufizimet e përcaktuara në këtë statut si edhe në vendime te mëvonëshme te Asamblesë së ortakëve.
- 14.7. Administratori mund te emërojë përfaqësues te posaçëm për veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1. Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund te shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti finanziar dhe bilanci vjetor

- 16.1. Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor te secilit vit.
- 16.2. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kerkuar nga Ligji n. 9901 te dates 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 16.3. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin finanziar duhet te bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i viti finanziar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpëndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria mund te prishet në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin finansiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kreive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Per çfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Statuti hartoitet ne 4 kopje originale. Nje kopje depozitoitet ne Zyren e Noterise Tirane, nje kopje ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nje kopje ne seline ligjore te shoqerise.

ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE

«ARTAN DERVISHI» Sh.p.k

ARTAN DERVISHI

ENIO HAXHIU

Artan Dervishi

Eni Haxhiu

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
N^{r.} 489 Rep.

NOTER

EMRI : EDLIRA S. HYSENI

ADRESA: Bulevardi "Zog I", Pallati 12 katesh, Kati i dyte, pranë Godines se "Z. Popullit".

VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë, sot me date 08. 02. 2018 (dymije e tetëmbedhjete), para meje Noterit Publik Edlira S. HYSENI, anetare e Dhomës se Notereve Tirane, u paraqitën personalisht shtetasit me ketë identitet:

1. **Artan DERVISHI**, atesia Haki, i lindur më 03.02.1977, ne Shijak, Durres, me dhe banues ne Shijak, Koxhas, Durres, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 029047581 dhe numer personal H70203012M.
2. **Enio HAXHIU**, atesia Bashkim, lindur ne Rreshen, me date 13.12.1991, dhe banues ne adresen: Shijak, Maminas, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit 027246275 dhe numer personal J11213074D.

Me vullnetin e tyre të lire e të plete, personat më siper pershkruar kanë redaktuar jashtë kesaj zyre me cilesine e Ortakëv e Themelues te Shoqerise "ARTAN DERVISHI" Sh.p.k. dokumentin bashkengjitur.

Nënskruesit deklarojnë se e kuptojnë tërësisht aktin bashkengjitur dhe pasojat e tij dhe akti u nenskrua prej tyre pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale ne kete zyre dhe para meje Noterit.

Une Noteri vertetoj rregullesin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij dokumenti si dhe autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise".

**NOTE
EDLIRA S. HYSENI**



A large, handwritten signature in black ink, appearing to read "Edlira S. Hyseni", is written over the circular stamp.